



“PRONËSI ME DREJTËSI” NATIONAL ASSOCIATION

Defending Property, Pursuing Justice

<http://defendingproperty.com>

P.O. Box 8195 • Tirana, ALBANIA

Phone: +355 33 22 4883

• E-mail: pronesi_me_drejttesi@yahoo.com

KRYEMINISTRIT TË REPUBLIKËS ZOTIT EDI RAMA

19.11.2013

I nderuar zoti Kryeministër.

Në emër të Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve „Pronësi me Drejtësi“ ju falenderojmë për qendrimin tuaj qytetar për pranimin e kërkesës së manifestuesve për të mos pranuar në Shqipëri arsenalin e helmeve kimike të Sirisë. Efektivisht duke zgjidhur ngërçin e krijuar nga protestat, ju fituat, por rilindja e Shqipërisë dhe demokracia e premtuar, akoma nuk kanë fituar.

Ju rikujtojmë se një problem tejet i rëndësishëm për popullin dhe kombin shqiptar është problemi i pronës. Për shkak të elementeve anti-pronarë në legjislacionin mbi pronat dhe keqzbatimit të elementeve pozitivë të këtij legjislacioni, në gjithë vendin dhe veçanërisht në zonat turistike, koha që kalon rëndon edhe më shumë pasojat e rënda nga mos respektimi i të drejtës së pronës, prezente në këto 20 vitet e fundit dhe shqiptarët çdo javë vazhdojnë të vriten me njëri tjetrin.

Ju gjatë vizitës në Frakull deklaruat: "*Çfarë 7501-shi e jep për tokën e bukës prej gati çerek shekulli dhe burrat po bëhen pleq pa e marrë, ndërsa fëmijët po bëhen burra pa e besuar se do ta marrin ndonjëherë, .., ne do ta japim në bazë të 7501-shit dhe pikë*". Shoqata jonë është thellësisht e preokupuar nga ky mendim. Ne konsiderojmë se ky qëndrim është thellësisht i padrejtë, qoftë nga pikpamja kushtetueso-ligjore, morale si dhe nga pikpamja sociale dhe e interesit kombëtar. Ligji 7501, me të cilin qeveritë 1991-2013 ndanë tokën për frymë dhe neni 8 i tij, është strumbullari i anarkisë së pronës.

1. Zbatimi me çdo kusht i ligjit 7501, çon në konflikt me zbatimin e nenit 181 të Kushtetutës, aty ku ka pronar legjitim të tokës. Kjo është platformë që prodhon korrupsion shtetëror, aq më tepër kur Kushtetuta në nenin specifik 181, që ka efekt prapaveprues, shpreh qartë dhe cakton afate (3 vjet) për zbatimin e një principi kaq të rëndësishëm.
2. Zbatimi me çdo kusht i ligjit 7501, do të thotë mungesë e stabilitetit social, vazhdim i vllavrasjeve dhe konflikte deri brenda fisit dhe familjes. Këtë e tregon niveli aktual alarmues 6000-8000 vrasje për shkak konflikti pronësie, që pak kohë më parë deputeti Namik Dokle dhe ish kryeministri Pandeli Majko e kanë denoncuar në Kuvend si bilanc lufte.
3. Zbatimi me çdo kusht i ligjit 7501, do të thotë të bllokosh pronën sepse në të gjitha rrethet e veriut që në vitin 1991, çdo trung familjar ka marrë pronën e trashëguar në kufijtë e para konfiskimit, por dokumentat shkresore janë plotësuar sikur prona është ndarë për frymë sipas ligjit 7501. Kjo pengon transaksionet e rregullta të këtyre pronave dhe investimet e huaja private në këto prona. Kompensimi për të zëvendësuar kthimin fizik të penguar nga neni 8 i ligjit 7501 është themeli i pluralizmit kleptokratik që zëvendësoi diktaturën komuniste pas vitit 1991, është burimi i korrupsionit dhe një maskë demokratike por katastrofike për stabilitetin social, financat dhe të ardhmen e Shqipërisë. Ky kompensim është ose gënjeshtër ose barrë e padrejtë financiare për të gjithë shoqërinë shqiptare për shumë breza.
4. Zbatimi me çdo kusht i ligjit 7501, do të thotë t'i imponosh shqiptarëve të pranojnë amoralitetin dhe imoralitetin, që ata të përvetësojnë pronat e njeri tjetrit.
5. Zbatimi me çdo kusht i ligjit 7501, do të thotë mohim i identitetit kombëtar. Prona e trashëguar është identiteti kombëtar dhe dinjiteti personal i mohuar nga pluralizmi partiak i postkomunizmit. Nëse shqiptarët bëhen pronar me ligjin 7501, atëherë kur fillon koha zero për këtë popull : në lashtësi, në 1944 apo 1991 ? Në një nivel më pragmatik, kjo do të

thotë që për shkak të pasigurisë dhe konflikteve të titujve të pronësisë, asnjëherë asnjë investitor serioz nuk do të guxojë të investojë në Shqipëri. Këtë e kanë evidentuar dhe raportet e Bankës Botërore.

6. Zbatimi me çdo kusht i ligjit 7501, do të thotë të mbrojtje e korrupsionit në administratën shtetërore dhe 8 institucionet përfshi AKKP, që në emër të ligjit shpallin pronar më të zotin por jo të zotin e pronës, bëjnë pronar atë që nuk ka qenë pronari i shpronësuar (i zoti) i asaj prone. Kjo do të thotë të kultivosh korrupsionin në gjykata dhe prokurori, të pengosh përafrimin në BE, të zgjatësh kohën e diktaturës komuniste të maskuar me fasadë demokratike.

7. Zbatimi me çdo kusht i ligjit 7501, është jo vetëm vazhdimësi e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe e Kushtetutës, por dhe tallje me një pjesë të mirë të elektoratit që ju ka mbështetur, duke besuar në premtimin tuaj elektoral se *“Për qeverinë e re nuk do të ekzistojë më termi “ish-pronar”.... do të zbatohet vetëm Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë për të drejtën e fitimit të pronës”*.

Zoti Kryeministër, zgjidhja e problemit të pronës nuk mund të jenë tapitë sipas ligjit 7501, që është bataku i pluralizmit kleptokratik 23 vjeçar R.Alia, S.Berisha, F. Nano që mban peng rilindjen dhe demokracinë për shqiptarët dhe është pengesë e integritetit në BE.

Zgjidhja e saktë e qëndrueshme dhe pa faturë financiare, është kthimi dhe kompensimi në përputhje me nenin 181 të Kushtetutës. Ky nen dhe e gjithë fryma e Kushtetutës duhet të jetë udhërrëfues për ju dhe Qeverinë që drejtoni. Në ju kërkojmë që ta bëni prioritet zbatimin e Kushtetutës. Në të kundërt nëse do keni udhërrëfues ligjin 7501, do ta zhysni vendin edhe më thellë në batakun e sistemit të kleptokracisë së pluralizmit postkomunist. Në këtë drejtim antikombëtar, do të mblidhet energjia negative e politikanëve të majtë dhe të djathtë që kanë përvetësuar pronë që atyre nuk ju përket.

Qeveria nuk do të jetë e besueshme sa kohë që nuk ekzekutojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë të gjykatave të vendit, përfshi dhe vendime të Gjykatës së Strasburgut. Qeveria dhe Shteti nuk mund të justifikohet me rezoluta për të mbrojtur pronat dhe të drejtat e popullsisë autoktone çame në Çamëri ndërkohë që prona mbetet fallco, fiktive dhe fjasko në Shqipëri.

Diskutimi i fundit që duhet të thuhet PO apo JO për armët kimike apo pak vjet më parë diskutimi për centralin atomik në Shqipëri është m[shum[çështje shkenc[ar[sh dhe spacialistësh pa p[rjashtuar popullin dhe vendimin e zyrtarizimit Kryeministri ndërsa „Prona tek i zoti“ është parim kushtetues, q[Kryeministri ka detyrim p[r ta zbatuar . Prona tek i zoti peshon shumë më tepër sepse [sht[parim zakonor, Biblik dhe Kuranor, etj. Që Shqipëria të bëhet dhe demokracia të përparojë duhet që ligji 7501, i cili është amenduar shumë herë, të ndryshohet, në mënyrë që neni 8 dhe nene të tjera të tij, të vijnë në përputhje me nenin 181 të Kushtetutës, që ka përparsi mbi gjithë legjislativonin. Pas kësaj me tapitë që do jepni, prona u kthehet të zotërve në përputhje me Kushtetutën. Vetëm kështu ju do të lini gjurmën tuaj pozitive në historinë e vendit. Nëse interesat ose dëshirat tuaja vetiake do të vendosen mbi detyrimin për të zbatuar Kushtetutën dhe të drejtat e njeriut, edhe kjo qeveri do vazhdojë të jetë e dëmshme për popullin dhe kombin shqiptar. Historia ka qenë është dhe do të jetë një gjykes i pakorruptushëm dhe pa ngjyra politike. Ashtu siç ju kemi shkruar në letrën e 22 tetorit 2013 botuar pas një jave në gazetat „Sot“, „Telegraf“ dhe „Zeri i Popullit“, sërish ju kërkojmë të merrni në konsideratë zgjidhjen sipas projektligjit që ju kemi ofruar. Kemi besim që ju do të keni vullnet politik, guxim dhe moral kombëtar që kryeministrave para jush u ka munguar.

Në pritje të përgjigjes, ne besojmë në mirëkuptimin dhe reagimin tuaj qytetar.

Kryetar i Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi”
Rrapo Hajredin Danushi